



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA Durrës  
KËSHILLI BASHKIAK

**PROÇESVERBAL**

**Nr. 22, datë 24.11.2022**

**I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës për muajin nëntor, që zhvillohet në sallën e Këshillit Bashkiak**

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:05

Data e mbajtjes së mbledhjes : 24.11.2022

Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Radhës

**Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës:** Kryetarja e Bashkisë znj.Emiriana Sako dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

**Ani Dyrmishi:** Përshëndetje !

Të nderuar Këshilltarë! E nderuar Kryetare! Të nderuar të Pranishëm!

Deklaroj të hapur këtë mbledhje të radhës për muajin nëntor.

Siç jeni vënë në dijeni nëpërmjet postës elektronike për rendin e ditës, në këtë mbledhje do të marrim në shqyrtim projektvendime të propozuara nga kryetarja e bashkisë, Komisioni i Mandateve dhe kryetari këshillit. Ftoj sekretaren e këshillit të bëj prezencën në sallë.

**Dorina Milja:** Përshëndetje! Fillojmë.

Jolanda Mustafaraj ... prezent.....deri tek.... Morena Boja...prezent.

37 këshilltarë në sallë.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Meqë kuorumi është i pranishëm, vazhdojmë me mbledhjen.

Po kaloj në leximin e pikave të rendit të ditës. Sot për shqyrtim e miratim kemi 11 pika projektvendime dhe 1 pikë informim.

1. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6% DHE FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË DURRËS, PËR MUAJIN NËNTOR 2022
2. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit të Komisionit Mandateve	PËR MBARIMIN PËRPARA AFATIT TË MANDATIT TË KËSHILLTARIT Z. JURGEN DASHI.
3. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit të Komisionit Mandateve	PËR MBARIMIN PËRPARA AFATIT TË MANDATIT TË KËSHILLTARES ZNJ. VALBONA BEGIÇI.
4. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit të Komisionit Mandateve	PËR MBARIMIN PËRPARA AFATIT TË MANDATIT TË KËSHILLTARIT Z. NAZMI BODLLI
5. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR NDRYSHIMIN E VKB-SË NR. 248, DATË 10.04.2015 ”PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË PËRFITUESVE PËR NDARJEN E BANESAVE SOCIALE ME QIRA ME STRUKTURË 2+1 DHE 1+1”, SEKSIONI I, (LAGJJA NR. 17, RRUGA “DALIP PEZA”), I NDRYSHUAR
6. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VKB NR.64, DATË 07.07.2020, PËRSA I PËRKET NDRYSHIMIT TË LISTAVE EMËRORE TË FAMILJEVE PËRFITUESE TË GRANTIT PËR RIKONSTRUKSIONIN OSE RIPARIMIN E BANESAVE TË DËMTUARA SI PASOJË E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019, PËR SHKAK TË NDRYSHIMIT TË KATEGORISË SË DËMIT TË SHKAKTUAR
Pika 7. Informim këshilltarëve	INFORMACION MBI PROCEDURËN E DALJES JASHTË PËRDORIMIT / TJETËRSIMIT TË AKTIVEVE TË PANEVOJSHME TË INSTITUCIONEVE NË VARËSI TË QENDRËS EKONOMIKE TË ARSIMIT.

Pika 8. Shtesë Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit të Kryetarit të Këshillit	PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË PUNËS SË KËSHILLIT TË BASHKISË DURRËS PËR PERIUdhËN JANAR – DHJETOR 2023
Pika 9. Shtesë Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 6'758'672 LEKË, AKORDUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË PËR BASHKINË DURRËS, PËR SUBVENCIONIMIN E QIRASË PËR FAMILJET, QË PËRMBUSHIN KRITERET LIGJORE PËR PËRFITIMIN E BONUSIT TË STREHIMIT
Pika 10. Shtesë Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË DYMBËDHJETË TË 31 SUBJEKTEVE PËRFITUESE, TË CILËT DO TË PËRFITOJNË MASËN E GRANTIT TË RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019, SIPAS PROJEKTIT MODEL
Pika 11. Shtesë Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E HARTËS SË PËRGJITHSHME TË PLAZHEVE TË LEJUARA KU DO TË USHTROHET VEPRIMTARIA SI STACION PLAZHI, SI DHE PLAZHET PUBLIKE PËR VITIN 2023
Pika 12. Shtesë Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN NDRYSHIMIT TË ANEKSIT NR. 1, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 32, DATË 26.03.2021 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT PËR 4 BANESA KOLEKTIVE, L. 17, RRUGA “LURA”, PALLATET NR. 1&3, DHE RRUGA “AHMET DAKLI”, PALLATET NR. 15&23, TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019
Pyetje e diskutime	DISKUTIME DHE PYETJE NGA KOMUNITETI

Atëherë përse i përket rendit të ditës kemi ndonjë koment nga ana këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të rendit të ditës?

Kundra?

Abstenim ? .....Nuk ka.

*Atëherë me 37 vota pro miratohet rendi i ditës.*

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 1**, i japim fjalën Komisionit të Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale znj.Klementina Meçi.

**Klementina Meçi:** Faleminderit! Mirëdita të gjithëve!

Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale mori në shqyrtim pikën e parë të rendit të ditës dhe vendosi në unanimitet të kaloj në mbledhjen e ditës së sotme sipas projektvendimit të dërguar nga bashkia. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit znj.Meçi.

Komente përsa i përket pikës 1 të rendit të ditës, kemi nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 1 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

*Atëherë me 37 vota pro miratohet pika 1 e rendit ditës.*

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 2**, i japim fjalën Komisionit të Mandateve z. Xhongoli.

**Kastriot Xhongoli** : Faleminderit Kryetar.

Atëherë Komisioni i Mandateve u mbledh dhe propozon “Për mbarimin përpara afatit të mandatit të këshilltarit z. Jurgen Dashi”. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Atëherë komente përsa i përket pikës 2 të rendit të ditës, kemi nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 2 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Ardian abstenon.

*Atëherë me 36 vota pro dhe 1 abstenim miratohet pika 2 e rendit ditës.*

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 3**, i japim fjalën z. Xhongoli.

**Kastriot Xhongoli** : Atëherë dhe për pikën 3, Komisioni i Mandateve ra dakort “Për mbarimin përpara afatit të mandatit të këshilltares znj. Valbona Begiçi”. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Atëherë komente përsa i përket pikës 3 të rendit të ditës, kemi nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 3 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....nuk ka.

*Atëherë me 37 vota miratohet pika 3 e rendit ditës.*

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 4**, i japim fjalën Komisionit të Mandateve z. Xhongoli.

**Kastriot Xhongoli** : Faleminderit.

Dhe për pikën 4, Komisioni i Mandateve ra dakort “Për mbarimin përpara afatit të mandatit të këshilltarit z. Nazmi Bodlli”. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Atëherë komente përsa i përket pikës 4 të rendit të ditës, kemi nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 4 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....nuk ka.

Atëherë me 37 vota pro miratohet pika 4 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 5**, i japim fjalën Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

**Etleva Budini**: Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike votoi unanimitisht pro “Për ndryshimin e VKB-së nr. 248, datë 10.04.2015 ”Për shqyrtimin dhe miratimin e listës emërore të përfituesve për ndarjen e banesave sociale me qira me strukturë 2+1 dhe 1+1”, seksioni I”, dhe e kalojmë sot në votim.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Atëherë komente përsa i përket pikës 5, kemi nga ana e këshilltarëve ?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 5 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë miratohet me 37 vota pro pika 5 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 6**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Rroshi.

**Alneida Rroshi**: Përshëndetje.

Komisioni Rregullores për pikën 6, me shumicë votash propozon për ta kaluar në votim. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

**Etleva Budini**: Edhe Komisioni ynë vendosi unanimitisht për kalimin sot në votim.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit .

Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Velçani.

**Etleva Velçani:** Përshëndetje. Faleminderit Kryetar.

Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës mori në shqyrtim pikën 6 të rendit të ditës dhe propozon kalimin në votim në mbledhjen e sotme Faleminderit.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 6, kemi nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 6 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 37 vota pro miratohet dhe pika 6 e rendit ditës.

- Kalojmë në **pikën 7**, i japim fjalën znj. Lindita Myhedini për informim mbi procedurën e daljes jashtë përdorimit / tjetërsimit të aktiveve të panevojshme të institucioneve në varësi të Qendrës Ekonomike të Arsimit.

**Lindita Myhedini (Drejtoresha e QEA-it):** Përshëndetje.

Në zbatim të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr.10296 dhe të udhëzimeve përkatëse, të VKB nr.94, datë 30.09.2020, VKB nr.97, datë 30.09.2020, VKB nr.80, datë 10.08.2020, VKB nr.101, datë 31.08.2021, VKB nr.102, datë 31.08.2021, VKB nr.95, datë 26.07.2021, VKB nr.110, datë 30.09.2021, VKB nr.112, datë 30.09.2021 dhe VKB nr.113, datë 30.09.2021 “Për miratimin për prishjen e detyruar të ndërtesave për shkak se janë dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e datës 26 Nëntor 2019”, një pjesë e shkollave të institucioneve arsimore u dëmtuan nga ky tërmet dhe një pjesë e materialeve duhet të nxirreshin jashtë përdorimit, të cilat edhe e kishin arritur normën e amortizimit dhe një pjesë e dëmtoi totalisht.

T'i bie shkurt, atëherë në zbatim të urdhërit nr.30 të zyrtarit autorizues u ngritën komisionet përkatëse për vlerësimin e aseteve përkatëse, komisionet e nxjerrjes së jashtëpërdorimit të këtyre aseteve. Komisionet pasi vlerësuan materialet, të cilat ishin të dëmtuara dhe jashtëfunksionit, komisioni jashtëpërdorimit bëri veërifikimin total të tyre dhe informohet këshilli në bazë të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 për vlerat që kapin këto asete të dëmtuara dhe të nxjerra jashtëpërdorimit.

Atëherë vlera e inventarit ekonomik:

Vlera fillestare	Amoritizimi	Vlera e mbetur për nxjerrje jashtëpërdorimit
28,568,475	20,518,415	8,050,060

Për pajisjet e labratorit mund t’Ju bëj me dije që pjesa më e madhe e tyre jaë dëmtuar nga tërmeti, pasi materialet e tyre janë materiale qelqi:

Vlera fillestare	Amoritizimi	Vlera e mbetur
10,798,140	9,360,911	1,437,229

Në këtë proces të nxjerrjes së jashtëpërdorimit kemi patur dhe një mjet transporti që ka shëbyer për shkollën më aftësi ndryshe, për fëmijët me aftësi ndryshe, i cili ishte një mjet që përdorej prej 24 vitesh dhe ishte amortizuar pothuajse.

Vlera e automjetit në kohën e ardhjes është 1.788.000 lekë

Vlera e amortizimit 1.680.489 lekë

Dhe ky komision duke patur dhe specialistin përkatës doli në konkluzionin që ky mjet nuk shërben më për këtë funksion.

Të gjitha këto materiale do t'i nënshtrohen metodës së ankandit, procesit të ankandit për tu shitur për skrap, ku këtu përfshihen dhe gjithë pjesa e tavolinave, e karrigeve të shkollave, të cilat janë të dëmtuara. Nga specialistët përkatës u bë vlerësimi i tyre në peshë, ku pesha e tyre arrin në 1100 kg për mjetin e transportit, për tavolina e karrige në 1936 kg dhe për të tjera 350 kg. Kjo ishte.

Kurse për kompiuterat "Ne" operojmë ku specialistët e IT bëjnë verifikimin e tyre, pasi nxirren jashtë nëpërmjet me një marrveshje me një shoqëri kalojnë në procesin e riciklimit.

Faleminderit.

*(p.s ky material i është dërguar me email këshilltarëve dhe dërguar me shkresë nr. prot 8172/4, datë 16.11.2022, për Këshillin Bashkiak nga QEA)*

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Keni ndonjë pyetje?

Atëherë s'ka.

- Kalojmë në **pikën 8** të rendit të ditës, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Rroshi.

**Alneida Rroshi**: Përshëndetje.

Komisioni Rregullores pasi mori në shqyrtim dhe pikën 8 të rendit të ditës, propozon për ta kaluar në votim. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Atëherë përsa i përket pikës 8, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 8 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 37 vota pro miratohet dhe pika 8 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 9**, i japim fjalën i japim fjalën Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

**Etleva Budini**: Për pikën 9 "Për miratimin e përdorimit të fondit prej 6'758'672 lekë", "Ne" kemi votuar unanimitisht.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit znj. Budini.

Komente përsa i përket pikës 9, kemi nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 9 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 37 vota pro miratohet dhe pika 9 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 10**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Rroshi.

**Alneida Rroshi:** Komisioni ynë pasi mori në shqyrtim dhe pikën 10, propozon për ta kaluar në votim. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

**Etleva Budini:** Gjithashtu edhe Komisioni ynë votoi pro miratimit të kësaj liste.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit .

Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Velçani.

**Etleva Velçani:** Edhe Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës vendosi pro kalimit në votim. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 10, kemi nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 10 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 37 vota pro miratohet dhe pika 10 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 11**, i japim fjalën Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Velçani.

**Etleva Velçani:** Po kryetar, faleminderit.

Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës pasi shqyrtoi relacionin dhe projektvendimin vendosi me shumicë votash kalimin në votim. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit.

Komisioni i Politikave të Zhvillimit të Turizmit znj. Budini.

**Etleva Budini:** Gjithashtu dhe Komisioni Turizmit votoi unanimit për miratimin e hartës së përgjithshme të plazheve.



**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Ka komente përsa i përket pikës 11, nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 11 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 37 vota pro miratohet dhe pika 11 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 12**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Rroshi.

**Alneida Rroshi**: Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike pasi mori në shqyrtim pikën 12, propozon për ta kaluar në votim. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

**Etleva Budini**: Gjithashtu edhe Komisioni ynë vendosi unanimisht për kalimin sot në votim.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit .

Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Velçani.

**Etleva Velçani**: Edhe Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës vendosi kalimin në votim. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 12, kemi ndonjë nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 12 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....

Atëherë, 3 abstenim dhe 34 vota pro, miratohet dhe pika 12 e rendit ditës.

**Diskutime** : Ka kërkuar fjalën znj. Boja.

**Morena Boja**: Atëherë, faleminderit. Përshëndetje të gjithëve.

Unë kam kërkuar fjalën për diskutim në lidhje me një shqetësim të banorëve të disa familjeve në Njësinë Administrative Manëz, ndaj kam kërkuar gjithashtu që të ishte këtu prezent dhe vet kryetari i Njësisë Administrative në Manëz, duke qënë se është në dijeni të situatës dhe ka kontaktuar deri pak para disa ditësh me këto banorë. Bëhet fjalë për disa familje, diku tek 15 familje, të cilat vazhdojnë akoma dhe sot, pra pasnesër bëhen 3 vjet nga tërmeti, dhe vazhdojnë të qëndrojnë në kontenier dhe nuk kanë marrë akoma zgjidhje për tek zona e re e rindërtimit. Me aq sa më është thënë qëndron një problem tek trualli i pallatit ku ata kanë jetuar dhe kanë blerë

faktikisht apartamentet, pasi sipas disa burimeve të informacionit më është thënë trulli ku ka qënë i ndërtuar pallati, që është shëmbur më pas me Vendim të Këshillit Bashkiak ka rezultuar me pronar. Unë doja të dija sot, se si do ndiqet kjo procedura e këtyre familjeve dhe kur do të akomodohen këto familje? Faleminderit.

**Emiriana Sako:** Faleminderit

Procesi i rindërtimit në Njësinë Administrative Manëz është ai që ka avancuar më shumë sesa në të gjithë njësitë e tjera dhe falë përfundimit jo vetëm të banesave individuale, por edhe pallateve. Ne kemi bërë të mundur akomodimin tashmë të qindra familjeve në Njësinë Administrative.

Objekti në fjalë që Ju ngrini shqetësimin është pjesë e pallateve të shembura ku banorët kanë jetuar atje për rreth 30, 35 viteve, pra shumë kohë më herët. Ky objekt në 96 është privatizuar, në 2008 është certifikuar, pra është dhënë certifikata e pronësisë një subjekti përfitues, në bazë të një procesi gjyqësor dhe për programin e rindërtimit këta banorë nuk kanë patur asnjëherë shtëpi, pra sot nuk kemi asnjë dokument zyrtar, certifikatë pronësie për banorët, për 15 familjet. Pavarësisht nga kjo është në prioritetin tonë zgjidhja e problematikës së tyre, sepse janë qytetarë të Durrësit dhe “Ne”, po përgatisim një material për t’ia prezantuar këshillit ku këto familje do t’i strehohjmë në bazë të Aktit Normativ nr.9, ku familjet përfituese, pra programet nuk janë vetëm për përfituesin e banesës por edhe për programet e strehimit, dhe në një nga këto kapituj ka mundësi që këto familje kanë mundësi që të strehohen në pallatet e reja duke u bazuar në Aktin Normativ nr.9 me një program strehimi. Materiali është duke u punuar nga administrata, do i prezantohet Këshillit Bashkiak brënda mbledhjes së radhës. Dhe “Ne” duam që të bëjmë dhe pjesën e shortimit pastaj të këtyre familjeve për tu bërë pjesë e lagjes së re të Manzës me programin e rindërtimit, por jo përfitues të apartamenteve, por të strehuar në këto apartamente, të cilat janë ndërtuar nga qeveria shqiptare. Faleminderit.

**Morena Boja :** Po me aq sa dëgjova nga përgjigja Juaj.

**Ani Dyrmishi :** Morena.

**Morena Boja :** Si ?

**Ani Dyrmishi:** Morena e jap unë fjalën. Bëre një pyetje të një qytetari dhe more përgjigje.

**Morena Boja :** Unë nuk mora përgjigjen tamam që bëra, prandaj po bëj disa pyetje të tjera për ta qartësuar.

**Emiriana Sako:** Përgjigjen e more, është që do të strehohen brënda këtij viti. Në rast se Këshilli Bashkiak e voton projektvendimin. Nuk do të fitojnë banesë, por do të përfitojnë nga programi i strehimit.

**Morena Boja :** Unë atë që dëgjova nga shpjegimi juaj, pra Ju thatë që ka vendim të x (iks) gjykate, që ka shpallur pronar, vetëm një person të vetëm për të gjithë pallatin.

**Emiriana Sako:** Por që nuk është banor i atij pallati. Ka një vendim gjykate që një subjekt është pronar.

**Morena Boja :** Ok, pra ka një vendim gjykate, ndërkohë që nga banorët më është thënë që ato kanë akte shit-blerje për apartamentin që ka në posedim dhe për më tepër është verifikuar nga Njësia Administrative që ato kanë qënë banorë në atë pallat. Tani pyetja ime është : Çfarë formash pronësie njih Zyra e Rindërtimit? Sepse po dalim që njohim disa forma pronësie atje ku duam dhe disa të tjera kur nuk duam.

**Emiriana Sako:** Normalisht të gjitha këto unë i përmenda në fjalën që thashë. Këto nuk janë familje që kanë certifikatë pronësie, pra unë nuk merrem se çfarë keni diskutuar me banorët. Ne merremi me dokumentat në bashki në momentin që ato kanë aplikuar, se ato kanë aplikuar në programin e rindërtimit. Kemi përgjigjet nga hipoteka për këta banorë dhe në momentin që nuk kanë një dokument pronësie, nuk kanë dokument që kanë poseduar apartamentin para shembjes së pallatit, pra nuk kanë dokument që të verifikojë pronësinë e tyre. Kanë jetuar aty prej vitesh, por pronar është dikush tjetër dhe do t'i trajtojmë me program strehimi, pra do të akomodohen në pallatet e reja në bazë të këtij programi brenda vitit 2022.

**Morena Boja :** Brënda këtij viti.

**Emiriana Sako:** 2022, po.

**Ani Dyrmishi:** Faleminderit Kryetare. Faleminderit të gjithëve. Mbledhjen e deklaroj të mbyllur për sot. Për mbledhjen e radhës do të njoftoheni nga sekretaria e këshillit.

*Ky proçesverbal mbyllet me nr. rendor 11 (njëmbëdhjetë) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset nga Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit, sipas Rregullores Këshillit dhe Proçesverbalit të Kryesisë dhe 2 Kryetarëve të Grupeve Politike në Këshill së datës 09.06.2022.*

**Mbajtësi i proçesverbalit:** Dorina Milja

**Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit :**

Kryetar i Këshillit Bashkiak :

ANI DYRMISHI

Zëvendëskryetar i Këshillit :

ZAMIRA MUSTAFARAJ

Sekretar i Këshillit Bashkiak :

DORINA MILJA

Kryetar i Grupit të Partisë Socialiste të KB :

AFRIM BAKAJ

Kryetar i Grupit të Pavarur të KB :

ETLEVA VELÇANI